

NIPT: M31730027F

Tirane, Nd. "Pallatet 1 Maji", Ap.180, Tirane

Datë 10.04.2025

KONTRATË SHITJE KUOTASH**NË LIDHJE ME KUOTAT NË SHOQËRINË "LOV TAXI" SHPK**

Sot më datë 10.04.2025, kjo kontratë shitje kuotash (**Kontrata**) u lidh midis palëve të mëposhtme:

1. **Z. Edvin Bica**, mbajtës ipasaportës me nr.I60819059K, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, këtu e më poshtë do ti referohemi si ("**Shitësi**"),
2. **Z. Përparim Billa**, mbajtëse i pasaportës me nr H70206062Q, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, këtu e më poshtë do ti referohemi si ("**Blerësi**"),

Secilit prej palëve të mësipërme do ti referohemi si "**Palë**", dhe së bashku atyre do ti referohemi si "**Palët**".

DUKE QENË SE

- A. Shitësi është ortak i Shoqërisë "**LOV TAXI**" shpk, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e organizuar dhe që ekziston nën ligjet e Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me NIPT M31730027F, me seli në Tirane, me kapital në vlerën 100.000 Lekë (njëqind mijë lekë), e ndarë në 2 (kuotave) kuotë, me vlerë nominale 100.000 Lekë, ("**Shoqëria**");
- B. Shitësi është pronar dhe mbajtës i 1 (një) kuote ose 40 % e kapitalit; dhe
- C. Shitësi do të shesë tek Blerësit dhe Blerësi do të blejë nga Shitësi 40 % të pjesëmarrjes së kuotave në kapitalin e Shoqërisë, që konsiston në 1 kuotë dhe që përfaqëson 40% % të kapitalit ("**Kuotat**").

Këtu e më poshtë, në konsideratë të kësaj kontrate shitje kuotash, Palët bien dakord si më poshtë:

NENI 1 BLERJA DHE SHITJA E KUOTAVE

- 1.1. Qëllimi i kësaj kontrate është transferimi nga Shitësi tek Blerësit e Kuotave, që përbëjnë 40% të pjesëmarrjes së Shitësit në kapitalin e Shoqërisë.
- 1.2. Pas transferimit të kuotave, me nënshkrimin e kësaj kontrate, Blerësi do të jetë pronar i 1 kuote që përfaqëson 100 % të kapitalit të Shoqërisë dhe Shitësi do të humbasë çdo të drejtë pronësie, çdo të drejtë mbi dividendin apo çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia mbi këto pjesë të Kuotave.

NENI 2 ÇMIMI I BLERJES DHE RREGULLIMI I ÇMIMIT

- 2.1 Çmimi total i blerjes së 40 % të kapitalit të Shoqërisë, që përfaqëson 1 kuotë është 40.000 lekë (dyzet mijë lekë) ose ekuivalenti në ndonjë monedhë tjetër i pranuar nga Shitësi ("**Çmimi i Blerjes**").
- 2.2 Në ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate, nga ana e blerësit është paguar çmimi total i saj, dhe se shitësi nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë pretendim në lidhje me pagimin e çmimit.

NIPT: M31730027F

Tirane, Nd. "Pallatet 1 Maji" , Ap.180, Tirane

NENI 3 PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT

3.1 Shitësi pranon dhe garanton se ka fuqi dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar dhe lidhur këtë Kontratë dhe përsa kohë nuk parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, asnjë veprim tjetër nuk është i nevojshëm të kryhet nga Shitësi për ta bërë këtë Kontratë të vlefshme dhe detyruese për Shitësin dhe me efekt detyrues kundrejt tij, në përputhje me termat e kësaj kontrate, apo për të kryer veprimet e parashikuara në këtë mënyrë.

3.2 Shitësi pranon dhe garanton se ai ka titull të plotë ligjor mbi 40% të Kuotavetë Shoqërisë "LOV TAXI" shpk dhe se nuk ka hyrë në ndonjë Kontratë tjetër, paraprake apo përfundimtare, për shitjen e Kuotave.

3.3 Shitësi pranon dhe garanton se Kuotat nuk janë subjekt i ndonjë barre, pengu në favor të ndonjë pale të tretë apo sekuestrimi nga ndonjë organ ligjzbatues.

NENI 4 PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË E BLERËSVE


4.1 Blerësi garanton se ekzekutimi dhe lidhja e kësaj kontrate është ligjërisht e autorizuar dhe se Blerësi nuk ka pengesa ligjore apo pengesa të tjera për të hyrë dhe për të lidhur këtë kontratë. Kjo Kontratë është lidhur dhe përfaqëson një detyrim ligjor, të vlefshëm, detyrues dhe të detyrueshëm për Blerësin.

SHITËSI

Edvin Bica

Edvin

Bica



Vula e Kompanisë

**BLERËSI**

Përparim Billa

Përparim

